



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 646 Prot.

Tiranë, më datë 27.04.2023

VENDIM  
Nr. 224, datë 27.04.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 27.04.2023:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin “Ndërhyrje restauruese, banesa Thanas Kaci”, Monument Kulture i Kategorisë së II-të, me Nr. Pasurie 3/46, Zona Kadastrale 8452, me vendndodhje Bashkia Gjirokastrë, me aplikues Elena Mamani dhe zhvillues Thanas Kaci dhe plotësimin e aplikimit me pikat e mëposhtme:
  - Të paraqitet dokumentacioni noterial i përfaqësisë ;
  - Të plotësohen specifikimet teknike me gjithë ndërhyrjet e parashikuara;
  - Të saktësohen grafikisht me detajet përkatëse ndërhyrjet në dritaret e banesës dhe këto zëra të reflektohen edhe në preventiv;
  - Të paraqitet dokumenti i pronësisë i objektit me status monument;
  - Të paraqitet deklarata e dakortësisë me fqinjin;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
3. Ndaj vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Klesta QIRICI

